



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 46/2024 regjistër (JR)
Datë 11.11.2024

Vendim nr. 11 (JR)
Datë 03.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 03.02.2026, ditën e martë, ora 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Periand Teta.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), pasi dëgjoi parashtrimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i përfaqësuar me autorizim nga prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi, i cili përfundimisht deklaroi heqjen dorë nga ankimi objekt shqyrtimi, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi

pushimin e shqyrtimit të çështjes, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, z. Periand Teta ka ushtruar detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Në zbatim të vendimit (JR) nr. 35, datë 17.07.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për të tria kriteret e rivlerësimit dhe pasi arriti në konkluzionet se z. Periand Teta, ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, si dhe ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 803, datë 01.10.2024, vendosi: “*Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë*”.

II. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

3. Kundër vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit, ka ushtruar ankim Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”), i cili çmon se ky vendim përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Në analizë të vendimit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi konstaton ekzistencën e mospërputhjeve mes rrethanave të rastit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të Komisionit.
4. Në referencë të kuadrit ligjor të zbatueshëm në lidhje me realizimin e procesit të rivlerësimit për ish-ndihmësit/këshilltarët ligjorë, Komisioneri Publik vëren se gjejnë zbatim këto dispozita kushtetuese dhe ligjore, neni 179/b, pika 4, fjalia e dytë e Kushtetutës dhe neni 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, pasi subjekti ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, në kushtet kur i është nënshtruar atij si ish-këshilltar/ndihmës ligjor, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë e Kushtetutës, dhe nuk kryen detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, pasi marrëdhëniet e tij të punës janë ndërprerë që në vitin 2017 nga ana e kësaj gjykate, e vetmja alternativë ligjore për Komisionin, mbetet zbatimi i dispozitave të nenit 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
5. Në përfundim, në analizë të rrethanave të faktit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni, duke aplikuar nenin 58, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk gjen mbështetje në faktet dhe parashikimet ligjore të këtij rasti dhe në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b”, të këtij ligji, kërkon: “*Ndryshimin e vendimit nr. 803, datë*

01.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe zbatimin e dispozitave të nenit 58, pika 2, të ligjit nr. 84/2016”.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

7. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.
9. Në seancën gjyqësore publike të datës 02.02.2026, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural të ankuesit nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa, te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, i cili u përfaqësua në gjykim nga z. Adnan Xholi, sipas tagrave të përfaqësimit të pasqyruara në autorizimin nr. 2532 prot., datë 22.01.2026, i cili në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, i qëndroi ankimit të Komisionerit Publik.
10. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, pasi analizoi rrethanat faktike mbi të cilat i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, dispozitat kushtetuese dhe ligjore të këtij procesi dhe legjislacionin mbi statusin e magjistratit, me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit dhe standardin e ndjekur nga Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, për ndihmësit/këshilltarët ligjor në Gjykatën e Lartë, pretendoi se ankimi i Komisionerit Publik është i pambështetur në prova dhe në ligj. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit.

11. Në kushtet kur palët nuk kishin kërkesa për hetim të mëtejshëm gjyqësor, trupi gjykues i konsultuar në vend, mbylli shqyrtimin gjyqësor dhe ftoi palët për të paraqitur konkluzionet përfundimtare. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i përfaqësuar nga z. Xholi, pasi analizoi dhe dëgjoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës dhe nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, deklaroi heqjen dorë nga ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik ndaj vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit Periand Teta, pasi u njoh me qëndrimin e mbajtur nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerësoi se në bazë të parimit të disponibilitetit është e drejtë e këtij institucioni të disponojë mbi ankimin e paraqitur, që ka vënë në lëvizje Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe, për këtë arsye, në mbështetje të nenit 451, shkronja “c” dhe nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, të vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes nr. 46/2024, datë 11.11.2024.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

12. Trupi gjykues, pasi është njohur me: (i) ankimin e paraqitur nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa, kundër vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Periand Teta; (ii) parashtrimet me shkrim dhe ato të referuara në seancën gjyqësore të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në të cilat përfundimisht deklaroi heqjen dorë nga ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik; si dhe (iii) parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, analizon sa vijon.
13. Kushtetuta, në nenin 179/b, pika 5 e saj, parashikon se: *Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...] dhe, sipas kësaj dispozite kushtetuese, janë subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik ata që vënë në lëvizje Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për kontrollin e vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi bazën e ankimit të paraqitur prej tyre.*
14. Neni 179/b, pika 10 e Kushtetutës parashikon se procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
15. Në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se: *Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra, sipas nenit E, paragrafi 2 i Aneksit. Në referencë të këtyre dispozitave kushtetuese, sidomos parashikimeve në nenin 179/b, pika 10 e Kushtetutës, trupi gjykues çmon se mjeti procedural i heqjes dorë nga ankimi, i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në kuadër të procesit të rivlerësimit, do të rregullohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.*
16. Ndërsa në dispozitat e veçanta të ligjit nr. 84/2016, nuk gjenden rregullime të posaçme për t'i dhënë zgjidhje një situatë si kjo e rastit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se në nenin 4, pika 6 e këtij ligji parashikohet se: *Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.*

17. Në këtë kontekst, në kushtet kur si Kushtetuta edhe ligji nr. 84/2016 nuk i rregullojnë drejtpërdrejt procedurat në lidhje me institutin e heqjes dorë nga ankimi, në referencë të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, konkretisht të nenit 1, pika 2, ku parashikohet se: *Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe*, dhe të nenit 44 të tij, në të cilin parashikohet se: *Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj* – trupi gjykues çmon se për të zgjidhur situatën konkrete duhet t’u referohet dispozitave të posaçme të Kodit të Procedurës Civile, që rregullojnë institutin e heqjes dorë nga ankimi dhe pasojat ligjore që prodhon ushtrimi i kësaj të drejte të ankuesit.
18. Në këto kushte, në konsideratë të deklarimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se heq dorë nga ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit, në zbatim të parimit se ankuesi statusin procedural të të cilit e ka fituar Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për shkak të kalimit procedural, është dhe mbetet titullari dhe disponuesi i vetëm i mjetit procedural për të kundërshtuar vendimet e Komisionit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, trupi gjykues vlerëson se gjendet para zbatimit të detyrueshëm të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet pasoja ligjore e heqjes dorë nga ankimi, sipas këtij përcaktimi: *Në çdo fazë të gjykimit të çështjes në apel, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqë dorë nga ankimi. Në këtë rast, vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit*.
19. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se vetë Kolegji nuk ka më lëndë procedurale për të shqyrtuar çështjen për të cilën është vënë në lëvizje dhe, në zbatim të dispozitës së cituar më lart, duhet të pushojë shqyrtimin e kësaj çështjeje në këtë fazë të procesit. Trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit, e cila ka pranuar referimet për zgjidhjen e çështjes në rastin e heqjes dorë nga ankimi të paraqitur prej palës ankuese, pikërisht në dispozitat e cituara më lart.
20. Në këtë kuptim, trupi gjykues, duke ndjekur të njëjtën logjikë referuese, atë të dispozitave të cituara më lart, konstaton se vendimi nr. 803, datë 01.10.2024, i Komisionit, ndaj të cilit ishte ushtruar ankim, prej të cilit u hoq dorë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në ushtrim të funksioneve të Komisionerit Publik, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje. Këtë situatë ligjore e rregullon qartësisht parashikimi i nenit 451, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile, e cila përcakton se: *Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr*.
21. Përfundimisht, trupi gjykues vlerësoi se, për shkak të heqjes dorë nga ankimi prej ankuesit, shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 46/2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Periand Teta.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 03.02.2026, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, jam kundër vendimit nr. 11, datë 03.02.2026, me të cilin, shumica e trupi gjykues vendosi: *“Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 46/2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 803, datë 01.10.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Perind Teta”*.

A. Për procedurën e ndjekur

2. Unë, gjyqtare në pakicë, procedurën e ndjekur nga shumica e konsideroj jo të drejtë dhe në kapërcim të dispozitave ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes në fjalë. Pavarësisht parashikimit në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 86/2016, se: *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”,* për rastin konkret, heqja dorë nga ankimi objekt shqyrtimi, nuk duhet të çojë në pushimin e shqyrtimit të çështjes, pasi neni 64 i Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin orienton drejtëpërdrejtë ligji nr. 84/2016, përcakton se: *“Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera”*. Për pasojë, kjo çështje është e natyrës administrative dhe jo pa qëllim ligji i posaçëm i këtij procesi të orienton në këtë dispozitë.
3. Qëndrimin e shumicës së trupit gjykues se: [...], për të zgjidhur situatën konkrete duhet t'u referohet dispozitave të posaçme të Kodit të Procedurës Civile, që rregullojnë institutin e heqjes dorë nga ankimi dhe pasojat ligjore që prodhon ushtrimi i kësaj të drejte të ankuesit, nuk e çmoj të drejtë, pasi, jo pa qëllim, ligji nr. 84/2016 nuk orienton në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të aplikuara nga shumica për pushimin e shqyrtimit të çështjes. Kodi i Procedurës Civile rregullon marrëdhëniet procedurale civile dhe nuk gjen zbatim në këtë çështje të karakterit administrativ. Ligjvënësi, jo pa qëllim, është kujdesur që në nenin 4, pika 6 e ligjit të posaçëm nr. 84/2016, të përcaktojë dispozitat e aplikueshme në këtë proces, konkretisht: *Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.*
4. Për analogji, në kushtet kur neni 179/b, pika 5, fjalia e fundit e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se *gjatë periudhës nëntëvjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje*, gjen zbatim edhe neni 31/b, pika 2 e ligjit organik të kësaj gjykate nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. [...]”*.
5. Në kushtet kur institucionet e rivlerësimit udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, paanësisë, transparencës, mbrojtjes së interesit publik, duke respektuar të

drejtat e subjektit të rivlerësimit, qëndrimin e shumicës se: “[...], nuk ka më lëndë procedurale për të shqyrtuar çështjen për të cilën është vënë në lëvizje dhe, [...], duhet të pushojë shqyrtimin e kësaj çështjeje në këtë fazë të procesit”, e vlerësoj të gabuar në drejtim të mbrojtjes së interesi publik.

6. Pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare, në të cilat deklarohet heqjen dorë nga ankimi, në asnjë rast Kolegji i Posaçëm i Apelit, si gjykata e vetme e këtij procesi, nuk mund të shmangë kompetencat kushtetuese dhe ligjore, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në mbrojtje të interesit publik e, për këto arsye, duhet të vijonte me shqyrtimin e çështjes, deri në zgjidhjen e saj në mënyrë përfundimtare.

B. Për themelin e çështjes

7. Unë gjyqtare në pakicë, në analizë të rrethanave faktike dhe legjislacionit të zbatueshëm të këtij procesi, për çështjen objekt shqyrtimi, analizoj dhe vlerësoj se:

7.1. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, dhe bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, është kualifikuar për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*. Në zbatim të neneve 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dorëzuar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.

7.2. Në zbatim të vendimit të Kolegjit me nr. 35 (JR), datë 17.07.2024, subjekti i rivlerësimit Perian Teta iu nënshtrua procesit të rivlerësimit në Komision në cilësinë e ish-këshilltarit ligjor, duke arritur rezultate në nivel besueshmërie dhe kualifikuese për të tria kriteret e rivlerësimit.

8. Në referim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 42, pikat 2 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ka qenë i njëjtë si për ndihmësat/këshilltarët ligjorë *ex officio*, ashtu edhe për ish-ndihmësat/këshilltarët ligjorë, ndaj kërkesë të Komisionerit Publik në ankimin e tij, lidhet me saktësimin e bazës ligjore sa i përket dispozitivit të vendimit të Komisionit, pasi rezulton se ka kontradiktë mes pjesës arsyetuese dhe urdhëruese të tij.
9. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, në kushtet që subjekti i rivlerësimit Perian Teta ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, për sa kohë aplikimi i nenit 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikon emërimin/refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ky tagër kushtetues i përket organeve të emërtesës, në rastin konkret Këshillit të Lartë Gjyqësor.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi